

Kisha e Manastirit Lindja e Shën Mërisë në Vodicë propozohet për monument kulture



Kisha e Manastirit Lindja e Shën Mërisë në fshatin Vodicë, Berat është propozuar nga DRTK-Berat për marrjen e statusit juridik monument kulture si rrjedhojë e punës gjurmuese, dokumentuese dhe studimore.

Kisha e Manastirit Lindja e Shën Mërisë është kishë njënefëshe, ku naosi me

përmasa të brendshme 9,3 x 5,6 m, është i mbuluar me çati druri dhe tavan të sheshtë. Ndërtuar në vitin 1777 dhe pikturuar në vitin 1805 sipas mbishkrimeve.

Sipërfaqja e kishës njënefëshe është 76 m², ndërsa po të përfshijmë narteksin dhe paraklisin e Shën Harallambit, duke e parë si një ndërtim të vetëm, ky objekt shkon në një sipërfaqe prej 177 m².

Faza e I-rë – Shek. XIII, gjurmët e absidës me teknikën e kluasonazhit; Faza e II-të – Rindërtim i kishës në vitin 1777; Faza e III-të – Ndërtim i paraklisit (kishëzës) së Shën Harallambit në fillim të shek. XIX; Faza e IV-t – Ndërtim i narteksit në vitin 1926; dhe Faza e V-të – Vitet '90 të shek. XX.

— [ATSH](#)